

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË “ VIVIA MEDSPA ” SHPK

Sot, më datë 23.02.2025 (dymijë e njëzet e pesë), në praninë e Ortakut të Vetëm Themelues të shoqërisë “ **VIVIA MEDSPA**” SHPK si më poshtë:

Ortak i Vetëm Themelues i shoqërisë “VIVIA MEDSPA” SHPK, është Z. Klodian Shehi, atësia Idriz, amësia Rife, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në adresë në Tiranë, lindur më 28/03/1981, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Leternjoftim ID nr. 034272660 dhe nr. personal I10328255P.

Bazuar në nenet 6 e vijues të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), nënshkruhet ky Akt Themelimi, në të cilin Ortaku i Vetëm Themelues shpreh vullnetin të themelojnë shoqërinë tregtare “**VIVIA MEDSPA**” SHPK, me kushtet si vijon:

NENI 1
Emri i shoqërisë

- 1.1. Emri i shoqërisë do të jetë “VIVIA MEDSPA” SHPK.
- 1.2. Ortaku i vetëm themelues i shoqërisë mban përgjegjësi të kufizuar deri në deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara të kapitalit bazë të shoqërisë.

NENI 2
Forma e shoqërisë

- 2.1. Forma e shoqërisë “VIVIA MEDSPA” SHPK (në vazhdim referuar si “Shoqëria”) do të jetë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas parashikimeve të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), derisa të vendoset ndryshe për shndërrimin në një formë tjetër ligjore të parashikuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.
- 2.2. Shoqëria është Person Juridik Privat Shqiptar.

NENI 3
Selia e shoqërisë

- 3.1. Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë, Shqipëri, në adresën: Tiranë, Njësia Administrative Nr. 10 Rruga Dëshmorët e 4 Shkurtit, Nr 16, Kati 23 me sipërfaqe 370.1m², Kati 24 me sipërfaqe 323.26m², Kati 25 me sipërfaqe 189.22 m², Tiranë
- 3.2. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose qytet tjetër brenda Republikës së Shqipërisë, si dhe ka të drejtë të hapë degë ose zyra përfaqësimi të saj kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

NENI 4

Kohëzgjatja e Shoqërisë

- 4.1. Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 4.2. Ortaku i Vetëm/ Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e tij një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

NENI 5

Objekti i veprimtarisë

Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë, por duke mos u kufizuar në të: Ofrimin e shërbimeve dhe trajtimeve të ndryshme në fushën e estetikës, dermatologjisë, parukerisë, kozmetikës, fizioterapisë, masazherisë, brenda dhe jashtë vendit. Hapjen e salloneve të bukurisë, qendrave të estetikës, parukerisë, fizioterapisë, masazherisë, SPA, hapje institutesh bukurie dhe estetike, qendra trajnimi dhe reabilitimi, institucion arsimor privat, kurse, të formimit profesional në fushën e estetikës, kozmetikës, parukerisë, fizioterapisë, masazherisë, brenda dhe jashtë vendit. Import-eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë, tregtim me shumicë dhe me pakicë edhe on-line, shpërndarjen me dhe/ose pa magazine, si kombëtare dhe ndërkombëtare, edhe me marrjen e mandateve të përfaqësimit me dhe/ose pa magazine, të artikujve dhe produkteve të ndryshme në fushën e estetikës, dermatologjisë, kozmetikës, parukerisë, fizioterapisë, masazherisë, SPA, si parfume, kremëra, bojra për flokë, shampo, vajra, të ndryshme, bimë dhe/ose industriale, aromatizues të llojeve të ndryshme, produkte të higjienës, bizhuteri, të artikujve dhe produkteve ushqimore të bukurisë të çfarëdo lloji përberje dhe vlerë, detergjente të llojeve të ndryshme, artikujve të konsumit të gjere etj. Import-eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë, tregtim me shumicë dhe me pakicë edhe on-line, shpërndarjen me dhe/ose pa magazine, si kombëtare dhe ndërkombëtare, edhe me marrjen e mandateve të përfaqësimit me dhe/ose pa magazine të makinerive, aparaturave, aparatura estetiko-mjekësore, aksesoreve dhe/ose pajisjeve të ndryshme në fushën e estetikës, dermatologjisë, kozmetikës, parukerisë, fizioterapisë, masazherisë, SPA. Shoqëria sipas nevojave të aktivitetit ka të drejtën e ushtrimit të çdo aktiviteti të ligjshëm, të lejueshëm për formën e shoqërisë, e cila nuk ndalohej me ligj.

NENI 6

Kapitali i Shoqërisë

- 6.1. Kapitali bazë i shoqërisë është në vlerën 500,000 (pesëqindmijë) lekë, i përbërë nga 1 (një) kuotë, me vlerë nominale prej 500,000 (pesëqindmijë) lekë.
- 6.2. Ortaku themelues zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit themeltar, e cila jep të drejtën e pjesëmarrjes prej 100% në kapitalin bazë të shoqërisë.
- 6.3. Kapitali themeltar është nënshkruar dhe paguar në tërësinë e tij nga ortaku i vetëm themelues.

NENI 7

Organet Drejtuese

7.1. Bazuar në dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar), organet drejtuese të shoqërisë janë:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve/Mbledhja e Ortakut të Vetëm — organi më i lartë vendimmarrës;

2. Administratori — organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.

7.2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

NENI 8

Administrimi

8.1. Shoqëria do të administrohet nga Administratori i saj, i cili mund të zgjidhet për një afat deri në pesë vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

8.2. Administratori i Shoqërisë “**VIVIA MEDSPA**” SHPK do të jetë, është Z. Klodian Shehi, i biri i Shehi, atësia Idriz, amësia Rife, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në adresë në Tiranë, lindur më 28/03/1981, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr. personal I10328255P i cili emërohet për mandat me afat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë riemërimi.

8.3. Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë, i cili i ushtron të drejtat e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi, apo nga një ose disa persona të autorizuar prej tij.

NENI 9

Ligji i aplikueshëm

9.1. Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, ky akt themelimi, si dhe parashikimet e Statutit të saj.

NENI 10

Regjistrimi

10.1. Shoqëria do të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga administratori dhe/ose një/disa person(a) të autorizuar prej tij për këtë qëllim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 11
Dispozitat përfundimtare

11.1 Ky Akt Themelimi përpilohet në 2 (dy) kopje në gjuhën shqip, dhe nënshkruhet nga ortakët e vetëm themelues.

ORTAKU I VETËM THEMELUES I
SHOQËRISË “VIVIA MEDSPA” SHPK
Përfaqësuar nga

Z. Klodian Shehi
Administrator